



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT

QENDRA E TRANSFERIMIT TE
TEKNOLOGJIVE BUJQESORE VLORE



100 Vjet Pavarësi

Rezultatet e permbledhura te projektit 3 viti 2012

1. Titulli i projektit :

“STUDIM, PROJEKTIM DHE MODELIM FERME NE PENTARI “

2. Drejtuesi i projektit : Enver Brahimsulaj

3. Kohëzgjatja : Janar – Dhjetor 2012

4. Buxheti total lekë : 100000 (Njëqindmijë)

5. Buxheti vjetor : 100000 lekë

6. Objektivat dhe rezultatet kryesore :

Objektivi I: Studime të efikasitetit ekonomik në pentari

Rezultati 1: Produktiviteti prodhimit të ullishteve të zakonshme dhe intensive për vaj

Ullishtet, ku u realizua studimi, janë mbi 50 vjecare dhe 80 % e tyre shtrihen 16 - 25 % pjerrësi. Numuri bimëve është 115-140 rrënjë/ha dhe 90 % e sipërfaqes është mbi ujë. U studjua produktiviteti prodhimit : kosto për ha, rrënjë, kg dhe për orë pune. Nga analiza e treguesve rezulton se kushtojnë : punimet mekanike 40 %, krasitja 3 herë, vjelja 5 herë, grumbullimi prodhimit 2 herë, kushtojne me shume nga normativat optimale të kryerjes se këtyre operacioneve. Zgjidhja do të ishte futja e mjeteve mekanike të përshtatshme për terrenin, përdorimi i mjeteve të thjeshta të krasitjes dhe vjeljes si krëhra plastik, pneumatik dhe Skedimi i grup fermave intensive të pentarisë që përfaqësojnë zonat përkatse elektrik që menaxhohen lehtësisht nga puntori, ulja e kurorës deri në 60-70 m³, përdorimi mushamave të përmasave 8x12 m ose 12x12 m për të reduktuar kohën e punës 2 herë.

Objektivi II: Studimi i kushteve tekniko-ekonomike të kultivimit dhe përpunimit të ullirit për kripje në zonën e Beratit.

Rezultati 1: Ndikimi i elementeve te teknologjise ne koston e prodhimit të ullirit Koker Madh i Beratit.

Realizimi koston së prodhimit dhe ndërhyrja për reduktimin e saj është qëllimi i studimit. Në kushtet e kultivimit të këtij varieteti në qarkun e Beratit, nga analiza e treguesve ekonomiko-financiar rezulton se : kosto e prodhimit është 115 lek/kg. Në strukturën e saj 51.5 % e zënë materialet, 31.6 % puna e krahut dhe 16.9 % mekanika. Bie në sy mekanizimi mjaft i kufizuar i

punimeve dhe niveli i lartë i punës së krahut, dy faktorë që ndikojnë ndjeshëm në efikasitetin e fermës, pa lënë pas dore përdorimin racional dhe të studjuar të bazës materiale sidomos pesticideve dhe plehrave kimike që zënë rreth 90 % të shpenzimeve të kësaj kategorie. Përmirësimi kushteve për rritjen e nivelit të mekanizimit dhe futjen e mjeteve të thjeshta për krasitjen dhe vjeljen e ullirit do të ishin dy elementë të rëndësishëm të kostos ku mund të ndërhyhet. Është provuar që dëmtimi i frutit në këtë rast shkon rreth 7-8 % që justifikohet tërësisht nga rritja e produktivitetit të prodhimit.

Objektivi III : Ndërthurja e elementëve tekniko-ekonomik në projektet e ullirit që subvencionohen

Rezultati 1 : Analize e zbatimit të studimit të ullirit në mbjelljet e vitit 2012

Rezultati 2 : Evidentimi i tipi të ullishteve

Rezultati 3 : Kostot e mbjelljes sipas tipit të ullishteve

Nga studimi rezulton se gjat vitit 2012 janë mbjellë 1719.9 ha dhe 598592 rrënjë ullinj, nga 120000 ha dhe 4382800 rrënjë të planifikuara sipas studimit. Subvencionet zënë 77 % dhe investimet nga fermeri 23 %. Krahasuar me vitin 2011 nuk ndryshon raporti në mes subvencionit dhe investimit por sipërfaqja e mbjellë është ulur me 44.4 %. Mbizotëron tipi i ullishteve tradicionale me 250-330 bimë/ha. Kultivarët e vendit zënë 30 % të sipërfaqes së mbjellë nga 71 % që duhet të jetë sipas studimit, ndërsa kultivarët e huaj zënë 70 % të sipërfaqes së mbjellë gjithsej nga 29 % të planifikuar. Edhe tek kultivarët për tavolinë dhe për vaj, për të dy tipet, rezulton i njëjti raport. Kosto sipas tipit të ullishteve rritet nga ato tradicionale tek intensivitet me rreth 30 %, por që justifikohet me rritje të prodhimit për shkak të numurit të rrënjëve për ha, kushteve të kultivimit dhe teknologjisë së përdorur.

Objektivi IV : Promovimi i vererave të kultivareve autokton të rrushit

Rezultati 1 : Vlerësimi i produktit

Sipas detyrave të programuara u morën kampione për 5 varietete rrushi autokton : shesh i zi, shesh i bardhë, kallmet, debinë e bardhë e Permetit dhe vlosh. Janë vënë në kushte fermentimi në përputhje me teknologjinë më të përparuar. Produkti do të realizohet në prill të vitit 2013. Do të kryhen analizat e përcaktuara dhe nëpërmjet tyre dhe degustimit, në një ditë fushe, do të përcaktohen varietetet më të mira, të cilat do të promovohen gjat vitit 2013 me artikuj divulgativ, nëpërmjet mediave, nëpërmjet internetit, me anë të flet palosjeve dhe në takime me aktorë të interesuar.

7. Aktivitetet kryesore :

1. Është bashkëpunuar me Shërbimet Këshillimore të qarqeve dhe ekstensionistë, me qëllim bashkëpunimi për realizimin e studimeve, saktësisht e të dhënave dhe plotësimin e formularëve.
2. Janë grumbulluar dhe përpunuar të dhënat për treguesit e përcaktuar për çdo objekt
3. Janë hartuar raportet përfundimtare për tre studime dhe është në përfundim raporti për ullirin Kokër Madh i Beratit.
4. Në projektin e vitit 2013 është planifikuar forma e publikimit të rezultateve të këtyre studimeve nëpërmjet takimeve zonale dhe rajonale me ekstensionistë e fermerë, temavetë trajnimit, ditëve të fushës, demonstrimeve, botime, flet palosje etj.

8. Mënyra e divulgimit të rezultateve në dobi të përfituesve :

- Organizimi në qarkun e Beratit i një takimi me fermerë dhe ekstensionistë të zonës , dhe më gjërë, për teknologjinë e kultivimit dhe përpunimit të ullirit për kripje.
- Organizimi i një dite fushe me fermerë dhe specialistë të qarkut Vlorë dhe zonat për rreth për degustimin dhe vlerësimin e vererave të varieteteve autoktone të rrushit.

- Publikim i rezultateve të studimeve të kryera në organe të ndryshme të shtypit në ndihmë të fermerëve për një zhvillim sa më efektiv të aktivitetit të tyre prodhues.

9. Rreziqet eventuale që parashikohen për mosrealizim të objektivave :

- Mungesa e informacionit për rezultatet e studimeve që përfshin ky projekt do të perbente nje faktor me pak në orientimin e fermerëve për zhvillimin efikas të aktivitetit të tyre menaxhues te prodhimit.

Propozimi i projektit 3 viti 2013

Titulli i Projektit 3 : **STUDIM, PROJEKTIM DHE MODELIM FERME NE PENTARI**

Drejtuesi Enver Brahimsulaj

Kohezgjatja (Fillim -Perfundim) Janar – Dhjetor 2013

Buxheti total lek (Per vitet sa zgjat projekti)

Buxheti vjetor

Objektivat kryesore

Objektivi I: E ardhmja e sistemeve të ullishtarisë marginale. Aspekte social-ekonomike, menaxhimi resurseve natyrale dhe cilësia e prodhimit.

Rezultati 1: Shtrirja e ullishtarisë marginale në raport me ullishte të mbjella gjithsej në rrethin e Vlorës.

Aktiviteti 1 : Evidentimi kushteve orografike të zonave me ullishtari marginale

Aktiviteti 2 : Skedimi dhe analiza e treguesve tekniko-agronomik

Aktiviteti 3 : Analiza e treguesve ekonomik-financiar dhe përcaktimi i efikasitetit të fermës

Rezultati 2 : Përcaktimi i disa elementëve tekniko-ekonomik për përmirësimin e menaxhimit të prodhimit në këto tipe ullishtesh.

Aktiviteti 1 : Menaxhimi i kurorës së ullirit dhe evidentimi i treguesve të rritjes dhe prodhimit

Aktiviteti 2 : Studimi i produktivitetit të metodave të ndryshme të krasitjes, vjeljes dhe trajtimeve antiparazitare me mjete të thjeshta mekanike.

Rezultati 3 : Divulgimi i rezultateve të studimit me qëllim shtrirjen e epërsive të teknologjive të reja që propozohen të futen në këto tipe ullishtesh

Aktiviteti 1 : Ditë fushe me ekstensionistë dhe fermerë të qarqeve : Vlorë, Fier, Elbasan dhe Tiranë për reduktimin e kurorës në këto tipe ullishtesh

Aktiviteti 2: Ditë fushe me këta aktorë për krasitjen e ullirit me mjete të thjeshta mekanike

Aktiviteti 3 : Ditë fushe për teknika të reja të vjeljes së ullishteve marginale

Aktiviteti 4 : Ditë fushe për rritjen e shkallës së mekanizimit në trajtime antiparazitare

Aktiviteti 5 : Paraqitja e rezultateve të studimit në takime me ekstensionistë dhe fermerë në qarqe ku shtrihen sipërfaqet më të mëdha të ullishtarisë marginale

Aktiviteti 7 : Hartimi i teknologjive të reja që mund të implementohen me efektivitet në ullishtet marginale dhe tradicionale

Rezultati 4 : Përlllogaritja e nevojave financiare për realizimin e këtij studimi

Aktiviteti 1 : Përcaktimi i mjeteve të thjeshta mekanike dhe vlerësimi financiar i tyre

Aktiviteti 2 : Përcaktimi i burimit të blerjes dhe atij financiar

Objektivi II: Studimi i organizimit të prodhuesve bujqësor, evidentimi dhe publikimi i epërsive në rritjen e efencës së fermës së pentarisë.

Rezultati 1: Evidentimi i përparësive të organizimit të prodhimit bujqësor në kooperativa.

Aktiviteti 1 : Shtrirja e kooperativave bujqësore të pentarisë në shkallë vendi

Aktiviteti 2 : Skedimi dhe marrja e të dhënave organizative, teknike dhe ekonomik-financiare

Aktiviteti 3 : Identifikimi i bazës ligjore dhe i zbatimit të tyre në krijimin e këtyre organizatave

Aktiviteti 4 : Analiza e treguesve financiar dhe pasqyrimi konkret i rezultateve të prodhimit

Rezultati 2 : Divulgimi i rezultateve me qëllim përhapjen e kasaj forme organizimi në vendin tonë

Objektivi III : Gjëndja aktuale e prodhimit të fidanave frutorë, problematikat dhe rrugët e përmirësimit në të ardhmen.

Rezultati 1 : Kushtet aktuale të prodhimit të fidanave frutorë

Aktiviteti 1 : Marrja e të dhënave nga fidashtet që shtrihen në zonën e ulët dhe bregdetare

Aktiviteti 2 : Evidentimi i kushteve teknike të prodhimit të fidanave të pemëve, ullirit, hardhisë dhe agrumeve

Aktiviteti 3 : Identifikimi i kushteve të tregëtimit dhe problemet që hasen

Aktiviteti 4 : Struktura e prodhimit të fidanave dhe përparësitë sipas zonave

Aktiviteti 5 : Analiza e treguesve ekonomiko-financiar dhe specializimi i prodhimit

Rezultati 2 : Divulgimi i rezultateve të studimit me aktorë të interesuar dhe entet që kontrollojnë e certifikojnë prodhimin e fidanave.

Objektivi IV : Planifikimi dhe ndjekja e kostove të prodhimit faktor i rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të fermës.

Rezultati 1 : Hartimi i manualit të kostove të prodhimit për kulturat drufrutorë në kushte të ndryshme zhvillimi dhe prodhimi

Aktiviteti 1 : Hartimi i kostove të prodhimit të pemëve frutore

Aktiviteti 2 : Hartimi i kostove të prodhimit të ullirit

Aktiviteti 3 : Hartimi i kostove të prodhimit të agrumeve

Aktiviteti 4 : Hartimi i kostove të prodhimit të kulturës së hardhisë

Rezultati 2 : Prgatitja, aprovimi dhe publikimi i manualit të kostove të prodhimit të këtyre kulturave

Rezultati 3 : Evidentimi i rezultateve dhe vënia në dispozicion të institucioneve dhe enteve të interesuara me qëllim orientimin e tyre për investimet që duan të planifikojnë për zhvillimin e këtij sektori

Objektivi V : Intensifikimi i prodhimit e ardhmja e zhvillimit të sigurtë të pemtarisë

Rezultati 1 : Shtrirja e fermave intensive të pemtarisë në shkallë vendi

Aktiviteti 1 : Skedimi i grup fermave intensive të pemtarisë që përfaqësojnë zonat përkatse

Aktiviteti 2 : Krijimi i bata base me të dhënat e grumbulluara

Aktiviteti 3 : Evidentimi i përhapjes së kultivarëve të koleksionit të pemëve frutore dhe hardhisë që administrojnë QTTB-ja Vlorë

Aktiviteti 4 : Analiza e treguesve ekonomiko-financiar të fermave intensive të pemtarisë

Rezultati 2 : Divulgimi i rezultateve të studimit nëpërmjet takimeve zonale dhe kombtare, mediave, internetit etj.

Rezultatet kryesore që do të arrihen (sipas cdo viti dhe perfundimtare)

Përcaktimi i strategjive të përshtatshme për të ardhmen e zhvillimit të ullishtarisë marginale në vendin tonë.

Identifikimi i problematikave dhe fenomeneve në prodhimin e fidanave frutorë në vendin tonë dhe rekomandime përkatse për mirësimin në të ardhmen.

Krijimi i nocioneve më të thella tek fermeri për planifikimin dhe ndjekjen e kostos së prodhimit si faktor i rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të të fermës.

Evidentimi i përparësive të organizimit të prodhuesve bujqësor si një element i ri prodhimi në sektorin e pemtarisë për rritjen e konkurrueshmërisë së produktit brenda dhe jashtë vendit.

Aktivitetet kryesore

1.Studimi i produktivitetit të metodave të ndryshme të krasitjes, vjeljes dhe trajtimeve antiparazitare me mjete të thjeshta mekanike.

2.Analiza e treguesve ekonomiko-financiar dhe përcaktimi i efikasitetit të fermës së ullishtarisë marginale

3. Ditë fushe me ekstensionistë dhe fermerë të qarqeve : Vlorë, Fier, Elbasan, Tiranë dhe Berat për reduktimin e kurorësvjeljes dhe krasitjes me mjete të thjeshta mekanike

4. Skedimi dhe marrja e të dhënave organizative, teknike dhe ekonomiko-financiare te kooperativave bujqësore në pentari, studimi dhe publikimi rezultateve.
5. Evidentimi i kushteve teknike të prodhimit të fidanave të pemëve, ullirit, hardhisë dhe agrumeve dhe paraqitja e rrugëve të përmirësimit.
Rreziqet eventuale qe parashikohen per mosrealizim te objektivave-----.
6. Pregatitja, aprovimi dhe publikimi i manualit të kostove të prodhimit të kulturave drufrutorë e vreshta
7. Skedimi dhe studimi i grup fermave intensive të pentarisë sipas qarqeve